

# PËRGJIGJA NDAJ KËRKESAVE PËR INFORMACION

Përpara se të dërgoni përgjigjen, duhet të siguroheni se ajo nuk zbulon padashur informacion të kufizuar sipas nenit nr. 17 të ligjit “Për të drejtën e informimit”.

## Në cilin format duhet ta jap informacionin?

Kërkuesi duhet të përcaktoj mënyrën e parapëlqyer të komunikimit në kërkesën e tij fillestare. Së pari, kontrolloni kërkesën fillestare përpara dërgimit të informacionit.

Përgjithësisht, informacionin duhet ta dërgoni në mënyrën me kosto më të ulët për autoritetin publik. Për shembull, nëse kërkuesi e ka dërguar kërkesën nëpërmjet postës elektronike dhe informacioni është dokument elektronik në formë standarde, atëherë do të ishte e arsyeshme t'i përgjigjeshit me anë të postës elektronike dhe të bashkëlidhni informacionin.

Nëse kërkuesi përcakton se i nevojitet versioni elektronik i një dokumenti, dhe kjo është e mundur, atëherë duhet t'ia jepni në atë format.

Gjithashtu, informacioni mund të jepet edhe në formate të tjera, për shembull, si material i printuar, ose t'i jepni mundësinë kërkuesit të shohë materialin origjinal. Nëse informacioni i kërkuar është një grup të dhënash, atëherë, nëse është e mundur, duhet ta jepni grupin e të dhënave në një format të hapur të ripërdorshëm.

## A mund ta refuzoj kërkesën për një format të caktuar?

Nëse nuk është e mundur që materiali të jepet në formatin e kërkuar, mund ta refuzoni dhe ta jepni në një format tjetër (nëse është e përshtatshme). Vendimet për refuzimin e formatit të kërkuar duhet të jepen me shkrim, duke përcaktuar qartë arsyen e refuzimit.

## Çfarë do të thotë të japësh informacion në “format të hapur të ripërdorshëm” ?

Ky term u referohet të dhënave digjitale dhe nënkupton se informacioni jepet në mënyrë të atillë që të mund të përdoret dhe shfrytëzohet nga kushdo, pa nevojën për programe softuerike të posaçme. Nëse do të jepni fletëllogaritëse, konsideroni mundësinë t'i dërgoni si skedarë .csv (një format i hapur), në vend të fletëve Excel (pasi kërkuesit do t'i duhej një program i veçantë për t'i hapur).

## A mundet autoriteti publik ta tarifojë shërbimin e dhënies së informacionit?

Përgjithësisht, shërbimi i të drejtës së informimit ofrohet pa pagesë. Megjithatë, autoriteti juaj publik mund ta tarifojë kërkuesin me koston e shumëfishimit të materialit dhe dërgimit postar. Kjo tarifë duhet të përcaktohet qartësisht në faqen tuaj të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut.

Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe kur është rasti, e dërgimit të tij. Informacioni i dërguar në rrugë elektronike jepet falas. Kostoja e riprodhimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja reale e materialit, mbi të cilin riprodhohet informacioni. Kostoja e dërgimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja mesatare e të njëjtit shërbim në treg.

Qytetarët që marrin ndihmë sociale dhe përfitojnë ndihmë juridike kanë të drejtë të marrin një numër të caktuar faqesh pa pagesë për çdo kërkesë. Ekziston një Udhëzim për t'ju ndihmuar të përcaktoni numrin e faqeve për të cilat informacioni përfitohet falas.

I gjithë informacioni i dhënë në rrugë elektronike duhet të jetë pa pagesë.

## A mund ta ndryshoj ose fsheh informacionin që është kërkuar?

Jo. Normalisht, duhet të jepni informacionin që dispononi në momentin e kërkesës. Mund të kryeni ndryshime rutinë të informacionit gjatë kohës së trajtimit të kërkesës, për sa kohë që këto ndryshime do të kryheshin pavarësisht kërkesës.

Nuk duhet të kryeni asnjë ndryshim ose fshehje për shkak të kërkesës, për shembull, për shkak se jeni të shqetësuar se disa nga informacionet mund të jenë shqetësuese (për autoritetin) nëse do të zbuloheshin.

Gjithësesi, ka disa raste kur informacioni i kërkuar mund të kufizohet. Të gjitha rastet e kufizimit të dhënies së informacionit përcaktohen në nenin 17 të ligjit “Për të drejtën e informimit”. Raste të veçanta mund të përcaktohen dhe në ligjet specifike.

*A ishte i dobishëm ky informacion? Nëse mendoni se duhet të shtojmë diçka tjetër te ky udhëzues, ju lutemi të na shkruani: [info@idp.al](mailto:info@idp.al)*